



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 4, datë 28.04.2021

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2020 ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 28.04.2021, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Kabinetit të Kryetarit të KD, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114, dhe pika 1 e nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (*ligji nr. 9918/2008*);
2. Neni 8 i ligjit 46/2015 “Për shërbimet Postare ne RSH” (*ligji nr. 46/2015*);
3. Vendim i Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” (*Vendimi i Kuvendit nr.134/2018*);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar (*Rregullore nr.7/2017*);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projekt-raporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2020;
2. Relacioni shpjegues mbi projekt-vendimin (Relacioni);
3. Projektvendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020”.

V Ë R E N:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2020 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila prej drejtorive të AKEP mbi veprimtarinë e kryer përgjatë vitit.
Gjithashtu dokumenti përmban edhe çështjet e detyrueshme për raportim të përcaktuara nga Kuvendi i RSH bazuar në Vendimin e Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në:
 - i. Nenin 9, të ligjit nr.9918/2008;
 - ii. Nenin 8, të ligjit nr.46/2015;
 - iii. Vendimin e Kuvendit të RSH nr.134/2018;
 - iv. Rregulloren e Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, të pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr.9918/2008 si dhe Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020”, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe një kopje e tij, t’i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020” ;
4. Ngarkohet Kabineti i Kryetarit të KD për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Ketrin Topçiu

Xhoana Lilaj

Lorenc Bako